
Thinking of you
Electrolux



EN3481AOW
EN3481AOX
EN3487AOH
EN3487AOJ
EN3487AOO
EN3487AOX
EN3487AOY

SQ	FRIGORIFER ME NGRIRJE	UDHËZIMET PËR PËRDORIM 2
CS	CHLADNIČKA S MRAZNIČKOU	NÁVOD K POUŽITÍ 24

PËRMBAJTJA

1. UDHËZIME PËR SIGURINË 3
2. PËRSHKRIM I PRODUKTIT 6
3. PANELI I KONTROLLIT 7
4. PËRDORIMI I PËRDITSHËM 10
5. UDHËZIME DHE KËSHILLA TË NEVOJSHME 13
6. KUJDESI DHE PASTRIMI 15
7. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE 16
8. INSTALIMI 19
9. TË DHËNA TEKNIKE 23

ME JU NË MENDJE

Faleminderit që bletë një produkt Electrolux. Ju keni zgjedhur një produkt i cili sjell me vete dekada të tëra me përvojë dhe risi nga profesionistë. Gjenial dhe elegant, ky produkt është projektuar duke ju pasur ju në mendje. Pra, sa herë që ta përdorni mund të ndjeheni të sigurt se çdo herë do të merrni prej tij rezultate të shkëlqyera.

Mirë se vini në Electrolux.

Vizitoni faqen tonë të internetit në adresën:

Merrni këshilla përdorimi, broshura, informacion për ndreqjen e problemeve si dhe për shërbimin:
www.electrolux.com

Regjistroni produktin tuaj për shërbim më të mirë:
www.RegisterElectrolux.com

Blini aksesorë, pjesë konsumi, pjesë këmbimi origjinale për pajisjen tuaj:
www.electrolux.com/shop

KUJDESI DHE SHËRBIMI PËR KLIENTËT

Rekomandojmë përdorimin e pjesëve origjinale të këmbimit.
Kur kontaktoni me Shërbimin, sigurohuni që të dispononi të dhënat e mëposhtme.
Informacioni mund të gjendet në pllakën e specifikimeve. Modeli, PNC, Numri i serisë.

Paralajmërim / Të dhëna për sigurinë dhe kujdesin.

Të dhëna të përgjithshme dhe këshilla

Të dhëna për ambientin

Rezervohet mundësia e ndryshimeve.

1. ⚠ UDHËZIME PËR SIGURINË

Në interes të sigurisë tuaj si dhe për një përdorim të saktë, përpara se të instaloni dhe të përdorni për herë të parë pajisjen, lexoni me kujdes këtë manual të përdoruesit, duke përfshirë këshillat dhe paralajmërimet. Për të shmangur gabime dhe aksidente të panevojshme, është e rëndësishme që të gjithë personat që do të përdorin këtë pajisje, të njohin mirë mënyrën e përdorimit dhe veçoritë e sigurisë. Ruajini këto udhëzime dhe sigurohuni që t'i bashkëngjiten pajisjes në rast se do ta falni apo do ta shisni atë, në mënyrë që kushdo që do ta përdorë gjatë jetëgjatësisë së saj, të jetë i mirinformuar për përdorimin e pajisjes dhe sigurinë ndaj saj.
Për sigurinë e jetës dhe pronës, zbatojini masat paraprake të udhëzimeve të përdorimit, pasi prodhuesi nuk mban përgjegjësi për dëmtime të shkaktuara nga pakujdesia.

1.1 Siguria e fëmijëve dhe personave me probleme

- Kjo pajisje nuk është përshtatur për përdorim nga personat (përfshirë fëmijët) me aftësi të kufizuara fizike, ndjesore apo mendore, ose me mungesë përvoje dhe njohurish, për sa kohë nuk janë të mbikëqyrur apo janë udhëzuar si të përdorin pajisjen nga një njeri përgjegjës për sigurinë e tyre.

  Fëmijët duhet të mbikëqyren për t'u siguruar që nuk luajnë me pajisjen.
- Mbajini të gjitha materialet e paketimit larg fëmijëve. Ka rrezik asfiksimi.
- Nëse do ta hidhni pajisjen, hiqni spinën nga priza, pritni kabllon e ushqimit (sa më pranë pajisjes sa të mundeni) dhe hiqni derën për të parandaluar fëmijët që luajnë të pësojnë ndonjë goditje elektrike apo të mbyllen vetë brenda.
- Nëse kjo pajisje që përmban brava magnetike të derës do të vendoset në vend të një pajisjeje të vjetër me bravë në trajtë suste (shul) mbi derë apo mbi kapak, sigurohuni që ta shkatërroni atë bravë përpara se të hidhni pajisjen e vjetër. Kjo do të parandalojë që pajisja të kthehet në rrezik vdekjeje për fëmijët.

1.2 Siguria e përgjithshme

⚠ **PARALAJMËRIM**

Mos i bllokoni vrimat e ventilimit në karkasën e pajisjes ose në strukturën inkaso.

- Pajisja është ndërtuar për të mbajtur ushqime dhe/ose pije në shtëpi dhe për përdorime të ngjashme, si p.sh.:
  - në zonat e kuzhinës për personelin në dyqane, në zyra dhe në ambiente të tjera pune;
  - në ferma dhe nga klientët në hotele, motele dhe ambiente të tjera banimi;
  - në ambiente me fjetje dhe mëngjes;
  - në katering dhe përdorime të ngjashme jo për shitje.
- Mos përdorni asnjë pajisje mekanike apo mjete artificiale për të përshpejtuar shkrirjen e akullit.
- Mos përdorni pajisje të tjera elektrike (si makinë akulloresh) brenda pajisjeve ftohëse, për sa kohë që nuk janë përshtatur për këtë nga prodhuesi.
- Mos e dëmtoni qarkun e lëndës ftohëse.
- Gazi ftohës (izobutani) (R600a) që ndodhet në qarkun ftohës të pajisjes, është një gaz natyror me një nivel të lartë pajtueshmërie me ambientin, por që është gjithsesi i ndezshëm.

  Gjatë transportimit dhe instalimit të pajisjes, sigurohuni që asnjë nga pjesët e qarkut ftohtës të mos dëmtohet.

  Nëse qarku ftohtës dëmtohet:
  - shmangni flakët e hapura dhe burimet ndezëse
  - ajrosni tërësisht dhomën në të cilën ndodhet pajisja
- Është e rrezikshme të ndryshoni specifikimet apo të përpiqeni ta modifikoni këtë produkt në çdo mënyrë të mundshme. Çdo dëmtim i shkaktuar në kabllo mund të shkaktojë qark të shkurtër, zjarr dhe/ose goditje elektrike.

PARALAJMËRIM
Çdo komponent elektrik (kabllo i ushqimit, spina, kompresori) duhet të zëvendësohet nga një agjent i certifikuar shërbimi ose nga një personeli i kualifikuar i shërbimit për të shmangur rreziqet.

1. Kablloja e ushqimit nuk duhet të zgjatet.
2. Sigurohuni që spina nuk është shtypur apo dëmtuar nga pjesa e pasme e pajisjes. Një prizë e shtypur apo e dëmtuar mund të mbinxehet e mund të shkaktojë zjarr.
3. Sigurohuni që priza e pajisjes të jetë lehtësisht e arritshme.
4. Mos e tërhiqni spinën nga kablloja.
5. Nëse priza e ushqimit është e liruar, mos futni në të spinën elektrike. Ka rrezik goditjeje elektrike ose zjarri.
6. Nuk duhet ta vini në punë pajisjen pa kapakun e llambës (nëse është parashikuar) së ndriçimit të brendshëm.

- Kjo pajisje është e rëndë. Bëni kujdes kur e lëvizni atë.
- Mos hiqni dhe mos prekni sende nga dhomëza e ngrirjes nëse i keni duart të njoma, pasi kjo mund të shkaktojë dëmtim të lëkurës ose djegie të shkaktuara nga bryma/ngrirësi.
- Shmangni ekspozimin e gjatë të pajisjes në dritën e drejtpërdrejtë të diellit.
- Llambushkat (nëse janë parashikuar) e përdorura në këtë pajisje janë llamba të posaçme të përzgjedhura vetëm për përdorim në pajisje elektro-shtëpiake. Ato nuk janë të përshtatshme për t'u përdorur për ndriçim dhome.

1.3 Përdorimi i përditshëm

- Mos vendosni enë të nxehta mbi pjesët plastike të pajisjes.
- Mos ruani brenda në pajisje gaz dhe lëng të ndezshëm, pasi këto mund të shpërthejnë.
- Mos vendosni produkte ushqimore drejtpërdrejt në zgavrën e daljes së ajrit që ndodhet në murin e pasmë. (Nëse pajisja është Pa formim bryme)
- Ushqimet e ngrira nuk duhet të ringrihen nëse janë shkrirë njëherë.
- Ushqimet e ngrira të paketuara paraprakisht, ruajini në pajisje sipas udhëzimeve të prodhuesit të ushqimit.
- Kështillat e prodhuesit të pajisjes për ruajtjen e ushqimeve, duhet t'i ndiqni me përpikmëri. Kështillohuni me udhëzimet përkatëse.
- Mos vendosni pije të gazuara ose shkumëzuese në dhomëzën e ngrirjes, pasi këto krijojnë presion brenda shishes dhe mund të shpërthejnë, gjë që do të dëmtojë pajisjen.
- Kubet e akullit mund të shkaktojnë djegie nëse konsumohen direkt nga pajisja.

1.4 Kujdesi dhe pastrimi

- Përpara se të kryeni veprime për mirëmbajtjen e pajisjes, fikeni atë dhe hiqeni nga priza.
- Mos e pastroni pajisjen me objekte metalike.
- Mos përdorni objekte me majë për të hequr brymën nga pajisja. Përdorni një kruajtëse plastike.
- Kontrolloni rregullisht sistemin kullues të frigoriferit nëse ka mbetur në të ujë i ngrirë. Nëse është e nevojshme, pastroni filtrin e kullimit. Nëse tubi kullues është i bllokuar, uji do të mblidhet në fundin e pajisjes.

1.5 Instalimi

Për lidhjet elektrike ndiqni me kujdes udhëzimet e dhëna në paragrafët e veçantë.

- Shpaketoni pajisjen dhe kontrolloni nëse ka dëmtime. Mos e lidhni pajisjen nëse ajo është e dëmtuar. Raportoni menjëherë dëmtimet e mundshme në vendin ku keni blerë pajisjen. Në këtë rast, ruajeni paketimin.
- Është e këshillueshme të prisni të paktën katër orë përpara se të lidhni pajisjen, për t'i lejuar vajit të rrjedhë në kompresor.
- Rrotull pajisja duhet të ketë një qarkullim të mjaftueshëm të ajrit, pasi mungesa e tij do të shkaktonte mbinxehje. Për të arritur ventilim të

mjaftueshëm, ndiqni udhëzimet përkatëse për instalimin.

- Aty ku është e mundur, pjesa e pasme e produktit duhet të vendoset pas murit për të shmangur prekjen ose kapjen e pjesëve të nxehta (kompresorit, kondensatorit), e për të shmangur djegie të mundshme.
- Pajisja nuk duhet vendosur pranë radiatorëve apo sobave.
- Sigurohuni që spina të jetë e arritshme pas montimit të pajisjes.
- Lidheni vetëm me ujë të pijshëm (Nëse nuk parashikohet lidhja me ujin).


1.6 Shërbimi

- Çdo ndërhyrje elektrike e nevojshme për instalimin e kësaj pajisjeje, duhet kryer nga një elektriçist i kualifikuar ose nga një person i aftë.
- Shërbimi i këtij produkti duhet të kryhet nga një Qendër e autorizuar Shërbimi, si dhe duhen përdorur vetëm pjesë këmbimi origjinale.

1.7 Mbrojtja e Mjedisit


Kjo pajisje nuk përmban gazra që mund të dëmtojnë shtresën e ozonit në qarkun e ftohësit apo në materialet izoluese. Pajisja nuk duhet të hidhet së bashku me plehrat e tjera të qytetit. Shkuma izoluese përmban gazra të ndezshëm: pajisja duhet të hidhet në përputhje me rregullat e zbatueshme të vendosura nga autoritetet tuaja lokale. Shmangni dëmtime në njësinë ftohëse, veçanërisht në pjesën e pasme pranë shkëmbyesit të nxehtësisë. Materialet e përdorura për këtë pajisje që kanë simbolin ♺ janë të riciklueshme.

2. PËRSHKRIM I PRODUKTIT



1 Sirtari CrispFresh
2 Sirtari FreshZone
3 Raftet prej xhami
4 Ftohja dinamike e ajrit
5 Kontrolli i lagështisë
6 Rafti i shisheve
7 Paneli i kontrollit
8 Rafti i gjalpit
9 Raftet e derës
10 Rafti i shkurtër
11 Rafti i shisheve
12 Koshat e ngrirësit
13 Etiketa e specifikimeve


3. PANELI I KONTROLLIT



1 Ekrani
2 Rregullatori i temperaturës
Butoni plus
3 Rregullatori i temperaturës
Butoni minus
4 Butoni Mode
5 Butoni DrinksChill dhe butoni ON/OFF
6 Butoni i dhomëzës së ngrirësit
7 Butoni i dhomëzës së ftohjes

Mund të ngrihet volumi i tingujve të paracaktuar të butonave duke shtypur njëkohësisht butonin Mode dhe butonin Minus për disa sekonda. Ndryshimi është i kthyeshëm.

3.1 Ekrani



A) Funksioni Demo
B) Treguesi i temperaturës së frigoriferit
C) Funksioni i pushimeve
D) Funksioni Eco Mode i frigoriferit
E) Funksioni i lagështisë së tepërt
F) Funksioni i blerjes
G) Funksioni Drinks Chill
H) Koha
I) Treguesi i temperaturës së ngrirësit
J) Funksioni Fast Freeze
K) Funksioni Eco Mode i ngrirësit
L) Treguesi i alarmit
M) Funksioni i bllokimit për fëmijët
N) Modaliteti fikur i frigoriferit

Pas zgjedhjes së dhomëzës së frigoriferit ose ngrirësit, nis animacioni ––––
Pas zgjedhjes së temperaturës animacioni pulson për pak minuta.

3.2 Ndezja

Ndiqni këto hapa për të ndezur pajisjen:

1. Futeni spinën në prizë.
2. Shtypni butonin ON/OFF nëse ekrani është i fikur.
3. Alarmi mund të futet në përdorim pas pak sekondash.

   Për ta ricilësuar alarmin referojuni kapitullit "Alarmi i temperaturës së lartë".
4. Treguesit e temperaturës tregojnë temperaturën e vendosur si të paracaktuar.

Për të zgjedhur një temperaturë tjetër, referojuni kapitullit "Rregullimi i temperaturës".

3.3 Fikja

Ndiqni këto hapa për të fikur pajisjen:

1. Shtypni butonin ON/OFF të pajisjes për 3 sekonda.
2. Ekrani do të fiket.
3. Për të shkëputur pajisjen nga rryma, hiqni spinën nga priza.

3.4 Fikja e frigoriferit

Për të fikur frigoriferin:

1. Shtypni butonin e dhomëzës së frigoriferit për pak sekonda.
2. Shfaqet treguesi OFF i frigoriferit.

3.5 Ndezja e frigoriferit

Për të ndezur frigoriferin:

1. Shtypni butonin e dhomëzës së frigoriferit.

   Treguesi OFF i frigoriferit fiket.

Për të zgjedhur një temperaturë tjetër, referojuni kapitullit "Rregullimi i temperaturës".

3.6 Rregullimi i temperaturës

Zgjidhni dhomëzën e frigoriferit ose ngrirësit.
Shtypni butonin e temperaturës për të vendosur temperaturën.
Temperatura e paracaktuar:

- +4°C për frigoriferin
- -18°C për ngrirësin

Treguesit e temperaturës tregojnë temperaturën e vendosur.
Temperatura e vendosur do të arrihet brenda 24 orëve.

Pas një shkëputjeje të energjisë, temperatura e vendosur mbahet e ruajtur.

3.7 EcoMode për sirtarin e frigoriferit dhe ngrirësit

Për ruajtjen optimale të ushqimit zgjidhni EcoMode.
Për të aktivizuar funksionin:

1. Zgjidhni sirtarin e frigoriferit/ngrirësit.
2. Shtypni butonin Mode derisa të shfaqet ikona përkatëse.

   Treguesi i temperaturës tregon temperaturën e vendosur:

   – për frigoriferin: +4°C
   – për ngrirësin: -18°C

3. Shfaqet treguesi EcoMode.

Për të çaktivizuar funksionin:

1. Zgjidhni sirtarin e frigoriferit/ngrirësit.
2. Shtypni butonin Mode për të zgjedhur një funksion tjetër ose shtypni butonin Mode derisa të mos shihni asnjë nga ikonat e veçanta.
3. Treguesi EcoMode fiket.

Funksioni çaktivizohet duke përzgjedhur një temperaturë të ndryshme.

3.8 Modaliteti ChildLock

Për të bllokuar veprime të mundshme me butonat zgjidhni funksionin ChildLock mode.
Për të aktivizuar funksionin:

1. Shtypni butonin e dhomëzës së frigoriferit dhe dhomëzës së ngrirësit për pak sekonda.
2. Shfaqet treguesi ChildLock mode.

Për të çaktivizuar funksionin:

1. Shtypni butonin e dhomëzës së frigoriferit dhe dhomëzës së ngrirësit për pak sekonda.
2. Treguesi ChildLock mode fiket.

3.9 Modaliteti i pushimeve

Ky funksion ju lejon që ta mbani frigoriferin të mbyllur dhe bosh gjatë një periudhe të gjatë pushimesh, pa lejuar që të krijohen aroma të këqija.

Dhomëza e frigoriferit duhet të jetë bosh kur funksioni i ditëve të pushimit është i aktivizuar.

Për të aktivizuar funksionin:

1. Shtypni butonin Mode derisa të shfaqet ikona përkatëse.

   Treguesi i temperaturës së frigoriferit tregon temperaturën e vendosur.

Për të çaktivizuar funksionin:

1. Shtypni butonin Mode për të zgjedhur një funksion tjetër ose shtypni butonin Mode derisa të mos shihni asnjë nga ikonat e veçanta.

Funksioni fiket duke përzgjedhur një temperaturë të ndryshme të frigoriferit.

3.10 Modaliteti DrinksChill

Modaliteti DrinksChill duhet të përdoret për të vendosur një alarm akustik në kohën e preferuar, i vlefshëm për shembull kur një recetë kërkon që të ftoh një përzierje për një periudhë të caktuar ose kur nevojitet një kujtues për të mos harruar shishet e vendosura në ngrirës për ftohje të shpejtë.
Për të aktivizuar funksionin:

1. Shtypni butonin DrinkChill .

   Treguesi DrinksChill shfaqet.

Kohëmatësi tregon vlerën e vendosur (30 minuta).

2. Shtypni butonin e uljes së temperaturës dhe butonin e ngritjes së temperaturës për ta ndryshuar vlerën e cilësuar të Kohëmatësit në 1 deri 90 minuta.
3. Kohëmatësi fillon të pulsojë (min).

Në fund të numërimit së prapthi treguesi DrinksChill pulson dhe dëgjohet një sinjal akustik:

1. Hiqni pijet që gjenden në dhomëzën e ngrirësit.
2. Shtypni butonin DrinkChill për të fikur tingullin akustik dhe për të përfunduar funksionin.

Funksionin mund ta çaktivizoni në çdo kohë gjatë numërimit së prapthi:

1. Shtypni butonin DrinkChill.
2. Treguesi DrinksChill fiket.

Është e mundur të ndryshohet ora gjatë numërimit të prapthi dhe në përfundim duke shtypur butonin e uljes së temperaturës dhe butonin e rritjes së temperaturës.

3.11 ShoppingMode

Nëse ju duhet të fusni në të një sasi të madhe ushqimi të ngrohtë, për shembull pasi sapo të keni bërë pazarin e ushqimeve, ju sugjerojmë të aktivizoni ShoppingMode për të ftohur më shpejt produktet dhe për të shmangur ngrohjen e ushqimeve të tjera që janë tashmë në frigorifer.
Për të aktivizuar funksionin:

1. Shtypni butonin Mode derisa të shfaqet ikona përkatëse.

ShoppingMode fiket automatikisht pas afro 6 orësh.
Për të çaktivizuar funksionin përpara ndalimit të tij automatik:

1. Shtypni butonin Mode për të zgjedhur një funksion tjetër ose shtypni butonin Mode derisa të mos shihni asnjë nga ikonat e veçanta.

Funksioni fiket duke përzgjedhur një temperaturë të ndryshme të frigoriferit.

3.12 Modaliteti FastFreeze

Për të aktivizuar funksionin:

1. Zgjidhni sirtarin e ngrirësit.
2. Shtypni butonin Mode derisa të shfaqet ikona përkatëse.

Ky funksion ndalon automatikisht pas 52 orësh.
Për të çaktivizuar funksionin përpara ndalimit të tij automatik:
Shtypni butonin Mode për të zgjedhur një funksion tjetër ose shtypni butonin Mode derisa të mos shihni asnjë nga ikonat e veçanta.

Funksioni çaktivizohet duke përzgjedhur një temperaturë të ndryshme të ngrirësit.

3.13 Modaliteti i lagështisë shtesë

Nëse ju duhet të rrisni lagështinë në frigorifer, sugjerojmë të aktivizoni funksionin e lagështisë shtesë.
Për të aktivizuar funksionin:
Shtypni butonin Mode derisa të shfaqet ikona përkatëse.
Për të çaktivizuar funksionin:
Shtypni butonin Mode për të zgjedhur një funksion tjetër ose shtypni butonin Mode derisa të mos shihni asnjë nga ikonat e veçanta.

3.14 Alarm ndaj temperaturës së lartë

Rritja e temperaturës në dhomëzën e ngrirësit (për shembull për shkak të një defekti elektrik) tregohet nëpërmjet:

- pulsimit të alarmit dhe treguesve të temperaturës së ngrirësit
- tingëllimit të ziles.

Për të rivendosur kohën:

1. Shtypni çdo buton.
2. Zilja fiket.
3. Treguesi i temperaturës së ngrirësit tregon temperaturën më të lartë që arrihet për disa sekonda. Pastaj tregon përsëri temperaturën e vendosur.
4. Treguesi i alarmit vazhdon të pulsojë derisa të rivendosen kushtet normale.

Kur alarmi të jetë kthyer, treguesi i alarmit do të fiket.

3.15 Alarmi i hapjes së derës

Do të dëgjohet një alarm akustik nëse dera lihet e hapur për pak minuta. Kushtet e alarmit të derës së hapur tregohen nga:

- treguesi i alarmit që pulson
- sinjalizuesi akustik

Pasi të jenë rregulluar sërish kushtet normale (dera e mbyllur), alarmi do të ndalojë.
Gjatë alarmit, sinjalizuesi mund të fiket duke shtypur çdo buton.

4. PËRDORIMI I PËRDITSHËM

4.1 Depozitimi i ushqimeve të ngrira

Kur e ndizni për herë të parë ose pas një periudhe të gjatë mospërdorimi, përpara se të futni produkte në dhomëz, lëreni pajisjen të punoj të paktën 2 orë.
Sirtarët e ngrirësit sigurojnë që të gjeni lehtë dhe shpejt paketën e ushqimit që dëshironi. Nëse ju duhet të magazinoni sasi të mëdha ushqimi, hiqni gjithë sirtarët përveç sirtarit të poshtëm që duhet të jetë në vend për të siguruar qarkullim të mirë të ajrit. Në të gjitha raftet është e mundshme që të vendosni ushqime që dalin jashtë deri në 15 mm nga dera.

Në rast të një shkrirjeje aksidentale, si për shembull për shkak të shkëputjes së rrymës elektrike, nëse ushqimi me energji ka zgjatur më shumë se vlera e treguar në tabelën e karakteristikave teknike në “koha në rritje”, ushqimi i shkrirë duhet të konsumohet shpejt ose të gatuhet menjëherë e më pas të vendoset sërish në ngrirje (pasi është ftohur).

4.2 Shkrirja e akullit


Ushqimet e ngrira, përpara se të përdoren, mund të shkrihen në dhomëzën ftohëse ose në temperaturën e dhomës, në varësi të kohës në dispozicion për këtë proces.
Copëzat e vogla të ushqimit mund të gatuhen edhe ndërsa janë ende të ngrira, direkt nga ngrirësi: në këtë rast, gatimi do të zgjasë më shumë.

4.3 Ngrirja e ushqimit të freskët

Dhomëza e ngrirësit është e përshtatshme për të ngrirë ushqime të freskëta si dhe për të ruajtur ushqime të ngrira për një kohë të gjatë.
Për të ngrirë ushqime të freskëta, aktivizoni funksionin e ngrirjes së shpejtë të paktën 24 orë përpara se të vendosni ushqimin që do të ngrini në dhomëzën e ngrirjes.
Vendosni ushqimin e freskët që do të ngrini në dhomëzën e poshtme.
Sasia maksimale e ushqimit që mund të ngrihet në 24 orë, specifikohet në pllakëzën e parametrave, një etiketë që ndodhet në brendësi të frigoriferit.
Procesi i ngrirjes zgjat 24 orë: gjatë kësaj periudhe mos shtoni ushqim tjetër për t'u ngrirë.
Pas 24 orësh, kur të jetë kryer procesi i ngrirjes, çaktivizoni funksionin e ngrirjes së shpejtë (shihni "Funksioni i ngrirjes së shpejtë").

4.4 Treguesi i temperaturës

Për t'ju ndihmuar që ta kontrolloni pajisjen mirë ne kemi instaluar një tregues temperature në frigoriferin tuaj.
Simboli anash tregon pjesën më të ftohtë të frigoriferit.
Pjesa më e ftohtë është nga rafti me xham i sirtarit të frutave dhe zarzavateve deri te simboli ose te rafti i vendosur në të njëjtën lartësi me simbolin.
Për të ruajtur më mirë ushqimin, treguesi i temperaturës duhet të tregojë mesazhin "OK".




Nëse "OK" nuk shfaqet, rregulloni kontrollorin e temperaturës në një parametër më të ftohtë dhe prisni 12 orë

përpara se të kontrolloni treguesin e temperaturës sërish.
Pasi të keni vendosur ushqimin e freskët në pajisje ose pasi të keni hapur derën vazhdimisht për një periudhë të gjatë, është normale që mesazhi "OK" të zhduket.

4.5 Raftet e lëvizshme

Muret e frigoriferit janë të pajisura me një sërë shinash në mënyrë që raftet të mund të vendosen sipas dëshirës.




4.6 Rafti i shisheve

Vendosini shishet (me grykën përpara) në raftin e vendosur paraprakisht.




Nëse rafti është i pozicionuar horizontalisht, vendosni vetëm shishe të mbyllura.
Ky raft shishesh mund të anohet, për të mbajtur shishe të hapura më parë. Për ta arritur këtë, tërhiqeni raftin sipër në mënyrë që të rrotullohet nga lart dhe të vendoset në nivelin tjetër më të lartë.



4.7 Ftohja me ajër

Teknologjia Multiflow bën që ushqimi të ftohet shpejt dhe me temperaturë më të njëtrajtshme në dhomëz.

Ky mekanizëm mundëson ftohjen e shpejtë të ushqimeve dhe temperaturë më të njëtrajtshme në dhomëz.




4.8 Filtri i ajrit me karbon

Pajisja është e pajisur me një filtër me karbon prapa një ventili në pjesën e pasme të kutisë shpërndarëse të ajrit. Filtri e pastron ajrin nga aromat e padëshiruara brenda në dhomëzën e frigoriferit gjë që do të thotë se cilësia e ruajtjes do të përmirësohet më shumë.

4.9 Vendosja e rafteve të derës


Për të lejuar ruajtjen e pakove të ushqimit të madhësive të ndryshme, raftet e derës mund të vendosen në lartësi të ndryshme. Për të bërë këto rregullime, veproni si vijon:
Tërhiqni gradualisht raftin në drejtim të shigjetave, derisa të lirohet, e më pas rivendoseni sipas dëshirës.



Mos e lëvizni raftin e madh të ulët të derës për të siguruar një qarkullim të mirë të ajrit.

4.10 Kontrolli i lagështisë


Kur ruani perime dhe fruta në frigorifer, bëni mirë që t'i vendosni ato brenda në sirtar. Frigoriferi siguron që temperatura të mbetet e ulët, duke ngadalësuar kështu prishjen. Në kushte normale, kur sirtari i perimeve nuk mbushet plotësisht dhe kur mban një përzierje me fruta dhe perime, kontrolli i lagështisë duhet të vendoset në pozicionin më të lartë të lagështisë që tregohet nga pika e madhe. Kjo do të thotë që grila e sipërme është e mbyllur dhe që brenda sirtarit ruhet një nivel i lartë lagështie. Ky duhet të jetë cilësimi standard. Ndonjëherë, kur sirtari është mbushur shumë, ekzistoni rreziku që perimet të mos ftohen mirë; në këto raste duhet t'i hapni fletët e grilës drejt pikës së vogël. Perimet ftohen normalisht vetë duke avulluar ujin dhe në rastin e fletëve të mbyllura, ekziston rreziku i grumbullimit të pikave dhe pellgjeve të ujit brenda. Perimet që mund të prodhojnë sasi të mëdha uji janë lakrat, kërpudhat, brokolit dhe karotat. Në rastet kur përzierja përmban mollë dhe fruta, mund të jetë ide e mirë që t'i mbani pak të hapura fletët në rast se ka rrezik akumulimi etileni brenda. Etileni është hormon rritjeje që lëshohet nga disa fruta dhe zarzavate, të cilat mund t'i dëmtojnë disa dhe mund të përshpejtojnë procesin e prishjes te të tjerat.



4.11 Sirtari Freshzone

Ky mekanizëm mundëson ftohjen e shpejtë të ushqimeve dhe temperaturë më të njëtrajtshme në sirtar.
Për të aktivizuar funksionin:

1. Ndizni funksionin e blerjeve.
2. Treguesi i blerjeve ndizet.
3. Rrëshqitni fletëzën lart siç tregohet në figurë.




Për të çaktivizuar funksionin:

1. Rrëshqiteni fletëzën poshtë.
2. Çaktivizoni funksionin e blerjeve.
3. Treguesi i blerjeve fiket.

Funksioni çaktivizohet automatikisht pas disa orësh.

4.12 Modaliteti FreshZone


Nëse dhomëza nuk nevojitet si FreshZone, cilësimet mund të ndryshohen për ta përdorur si sirtar me temperaturë të ulët.
Rrëshqitni fletëzën lart siç tregohet në figurë.
Për ta çaktivizuar funksionin, rrëshqisni për poshtë fletëzën.



4.13 QuickChill e pijeve

Ky funksion mundëson ftohjen e shpejtë të pijeve.
Për të aktivizuar funksionin:

1. Hiqni ose vendosni lart sirtarin Freshzone dhe vendosni mbajtësen e shisheve përballë vrimave të QuickChill siç tregohet në figurë.
2. Ndizni funksionin e blerjeve.
3. Treguesi i blerjeve ndizet.
4. Rrëshqitni fletëzën lart siç tregohet në figurë.




Për të çaktivizuar funksionin:

1. Rrëshqiteni fletëzën poshtë.
2. Çaktivizoni funksionin e blerjeve.
3. Treguesi i blerjeve fiket.

Funksioni çaktivizohet automatikisht pas disa orësh.

4.14 Heqja e koshave të ngrirjes nga ngrirësi

Koshat e ngrirjes kanë një pikë ndalimi për të parandaluar heqjen ose rënien aksidentale. Në momentin e heqjes nga ngrirësi, tërhiqeni koshin drejt vetes dhe kur të arrini në pikën e ndalimit, hiqeni koshin duke e ngritur lart pjesën e përparme.



Në momentin e vënies në vend, ngrini pak pjesën e përparme të koshit për ta futur në ngrirës. Pasi të keni arritur pikat e ndalimit, shtyjini koshat sërish në vend.

5. UDHËZIME DHE KËSHILLA TË NEVOJSHME

5.1 Tingujt e Funksionimit Normal

- Mund të dëgjoni një gurgullimë të lehtë kur frigoriferi pompohet nëpërmjet bobinave ose tubave. Është normale.
- Kur kompresori është i ndezur, frigoriferi pompon ujin dhe do të dëgjoni një tingull si uturimë dhe një zhurmë dridhëse nga kompresori. Është normale.
- Zgjerimi termik mund të shkaktojë një zhurmë të papritur kërcitëse. Është një fenomen i natyrshëm dhe jo një fenomen fizik i rrezikshëm. Është normale.

5.2 Këshilla për kursimin e energjisë

- Mos e hapni shpesh derën e frigoriferit ose mos e lini atë absolutisht të hapur më shumë se ç'duhet.
- Nëse temperatura e ambientit është e lartë, Rregullatori i Temperaturës është vendosur në përzgjedhjen më të lartë dhe pajisja është e mbushur plot, kompresori mund të punojë pa pushim duke shkaktuar formimin e ngricës ose akullit në aparatin e avullimit. Nëse kjo gjë ndodh, rrotulloni Rregullatorin e Temperaturës drejt një përzgjedhjeje më të ulët për të lejuar shkrirjen automatike dhe si rrjedhojë kursimin e konsumit të energjisë.

5.3 Këshilla për ftohjen e ushqimeve të freskëta

Për të arritur një funksionim më të mirë:

- mos depozitoni ushqime të ngrohta apo lëngje që avullojnë në ftohës;
- mbuloni me kapak ose mbështillni ushqimin, veçanërisht nëse ka një erë të fortë;
- vendoseni ushqimin në mënyrë të tillë që ajri të qarkullojë lirshëm rreth tij.

5.4 Këshilla për ftohjen

Këshilla të nevojshme:
Mish (të gjitha llojet) : mbështillini në qeska polietileni dhe vendosini mbi raftin e xhamit që ndodhet mbi sirtarin e perimeve.
Për siguri, ruajini në këtë mënyrë jo më shumë se një ose dy ditë.
Ushqime të gatuara, gatesa të ftohta etj.: këto duhet të mbulohen dhe mund të vendosen në çdo raft.
Frutat dhe perimet: këto duhet të pastrohen mirë dhe të vendosen në sirtarin e posaçëm. Kur bie në kontakt, lëngu i limonit mund të çngjyrosë pjesët plastike të frigoriferit. Si rrjedhim, rekomandohet që t'i mbani agrumet në enë të veçanta.
Gjalpi dhe djathi: këto duhet të vendosen në mbajtëset e posaçme hermetike ose të mbështjella në letër alumini ose qeska prej polietileni, për të lejuar brenda sa më pak ajër të jetë e mundur.
Shishet: këto duhet të kenë një kapak dhe duhet të vendosen në mbajtësen e shisheve te dera.
Bananet, patatet, qepët dhe hudhrat, nëse nuk janë të paketuara, nuk duhet të mbahet në ftohës.

5.5 Këshilla për ngrirjen

Për t'ju ndihmuar të kryeni pjesën më të madhe të procesit të ngrirjes, ja tek keni disa këshilla të rëndësishme:

- sasia maksimale e ushqimit që mund të ngrihet në 24 orë. është shfaqur në tabelën e vlerave;
- procesi i ngrirjes zgjat 24 orë. Nuk duhet shtuar ushqim tjetër për t'u ngrirë gjatë kësaj periudhe;
- ngrini vetëm ushqime të cilësisë më të lartë, të freskëta dhe të pastruara mirë;
- përgatitni ushqimin në racione të vogla për të mundësuar ngrirjen e tij të shpejtë dhe të plotë si dhe për të bërë të mundur si rrjedhojë shkrirjen e tij në sasinë e dëshiruar;
- mbështilleni ushqimin me letër alumini ose polietileni dhe sigurohuni që paketimi të jetë hermetik;
- mos lejoni ushqimet e freskëta, të pangrira, të prekin ushqimet që janë tashmë të ngrira, në mënyrë që të shmangni një rritje temperature të këtyre të fundit;
- ushqimet pa dhjamë ruhen më mirë dhe më gjatë se ushqimet e yndyrshme; kripa redukton jetëgjatësinë e ruajtjes së ushqimit;
- akujt e ujit, nëse konsumohen menjëherë pas nxjerrjes nga dhomëza e ngrirjes, mund të shkaktojnë djegie të lëkurës nga ngrirja;
- është e këshillueshme të shënoni në çdo pako ushqimi të ngrirë datën e ngrirjes, për të pasur parasysh kohën e ruajtjes.

5.6 Këshilla për depozitimin e ushqimeve të ngrira

Koshat e ngrirësit sigurojnë që të gjeni lehtë dhe shpejt paketën e ushqimit që dëshironi. Nëse ju duhet të magazinoni sasi të mëdha ushqimi, hiqni gjithë sirtarët përveç koshit të poshtëm që duhet të jetë

në vend për të siguruar qarkullim të mirë të ajrit.
Për të arritur një rendiment sa më të lartë nga kjo pajisje, duhet:

- të siguroheni që ushqimet e ngrira që keni blerë të jenë ruajtur siç duhet nga shitësi;
- të siguroheni që ushqimet e ngrira të transportohen nga dyqani në ngrirës brenda një kohe sa më të shkurtër;
- të mos e hapni shpesh derën e frigoriferit ose mos e lini atë hapur më shumë se ç'duhet;
- pasi e keni shkrirë, ushqimi prishet shpejt dhe nuk mund të ngrihet sërish;
- të mos e tejkaloni periudhën e ruajtjes të përcaktuar nga prodhuesi i ushqimit.

6. KUJDESI DHE PASTRIMI

6.1 Pastrimi i brendësisë së pajisjes

Përpara së të përdorni pajisjen për herë të parë, pastroni pjesën e saj të brendshme dhe gjithë aksesorët e brendshëm me ujë të vakët dhe pak sapun natyral për të hequr erën tipike të një produkti të ri, e më pas thajeni tërësisht.

Mos përdorni detergjent apo pluhura gërryese, pasi këto mund të dëmtojnë pjesët e lëmuara.

KUJDES
Shkëputeni nga korrenti pajisjen përpara se të kryeni çdo veprim mirëmbajtjeje.

Kjo pajisje përmban hidrokarbure brenda njësisë ftohëse; për këtë arsye, mirëmbajtja dhe rimbushja duhet të kryhen vetëm nga teknikë të autorizuar.

6.2 Procedura e larjes së shpërndarësit të ujit

Pajisja duhet pastruar rregullisht:

- pastroni brendësinë dhe aksesorët me ujë të vakët dhe me pak sapun.
- kontrolloni rregullisht bravat e derës dhe pastrojini ato për t'u siguruar që janë të pastra dhe nuk kanë papastërti.
- shpëlajeni dhe thajeni tërësisht.

Mos tërhiqni, lëvizni apo dëmtoni asnjë tub dhe/ose kabllot brenda kabinetit.
Mos përdorni kurrë detergjent, pluhura gërryese, produkte pastruese me shumë erë të mirë ose pastrues me dyllë për të pastruar brendësinë e pajisjes, pasi këto mund të dëmtojnë sipërfaqet dhe mund të lënë një erë të fortë.

Pastroni kondensatorin (skarën e zezë) dhe kompresorin në pjesën e pasme të pajisjes, me një furçë. Ky veprim do të përmirësojë rendimentin e pajisjes dhe do të kursejë konsumin e energjisë.

Kujdesuni që të mos dëmtoni sistemin ftohës.


Shumë pastrues për sipërfaqe kuzhine përmbajnë kimikate që mund të sulmojnë/ dëmtojnë lëndën plastike të përdorur në këtë pajisje. Për këtë arsye, këshillohet që veshja e jashtme e kësaj pajisjeje të pastrohet vetëm me ujë të ngrohtë me pak lëng larës.
Pas pastrimit, rilidheni pajisjen me ushqimin kryesor.

6.3 Zëvendësimi i filtrit të karbonit për ajrin

Për të arritur funksionim optimal, filtri i karbonit për ajrin duhet të ndërrohet një herë në gjashtë muaj.
Filtra të rinj aktivë të ajrit mund të blihen pranë shitësit tuaj lokal.
Referojuni "Instalimi i filtrit " për udhëzime për filtrin e karbonit për ajrin.

6.4 Shkrirja e frigoriferit

Bryma eliminohet automatikisht nga avulluesi i dhomëzës së frigoriferit sa herë që kompresori i motorit ndalon, gjatë përdorimit normal. Uji i shkrirjes shkarkohet nëpërmjet një vrime kullimi brenda një mbajtëseje të posaçme që ndodhet në pjesën e pasme të pajisjes, mbi kompresorin e motorit, ku dhe avullon.
Është e rëndësishme të pastroni periodikisht vrimën e shkarkimit të ujit të shkrirjes që ndodhet në mes të kanalit të dhomëzës së ftohjes, për të parandaluar që uji të rrjedhë e të pikojë mbi ushqimin brenda.
Përdorni pastruesin e posaçëm që ju është dhënë, të cilin do ta gjeni të futur në vrimën e kullimit.



6.5 Shkrirja e ngrirësit

Gjithashtu, dhomëza e ngrirjes në këtë model është e llojit "pa ngricë". Kjo do të thotë se gjatë procesit të punës nuk krijohet ngricë, as në muret e brendshëm as mbi ushqime.
Moskrijimi i ngricës vjen si rezultat i qarkullimit të vazhdueshëm të ajrit të ftohtë brenda dhomëzës, që vihet në punë nga një ventilator automatik.

7. ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

KUJDES
Përpara se të kryeni veprime për mirëmbajtjen e pajisjes, hiqeni atë nga priza.
Vetëm elektricistët e kualifikuar ose personat kompetentë duhet të merren me problemet ose defektet që nuk përshkruhen në këtë manual.

Gjatë përdorimit normal dëgjohen disa tinguj (nga kompresori, qarkullimi i lëndës ftohëse).

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Pajisja bën zhurmë.	Pajisja nuk është mbështetur mirë në dysheme.	Kontrolloni nëse pajisja qëndron pa lëvizur (të katër këmbët e saj duhet të kenë prekur tokën).

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Kompresori punon pa ndërprerje.	Rregulluesi i temperaturës mund të jetë në pozicion të gabuar.	Vendosni një temperaturë më të lartë.
	Dera nuk është mbyllur mirë.	Shihni kapitullin "Mbyllja e derës".
	Dera është hapur shumë shpesh.	Mos e mbani derën hapur më shumë se ç'nevojitet.
	Temperatura e produkteve është tepër e lartë.	Lëreni temperaturën e produkteve të bjerë në temperaturën e ambientit, përpara se ta lini në ruajtje.
	Temperatura e dhomës është tepër e lartë.	Ulni temperaturën e mjedisit.
	Funksioni i ngrirjes së shpejtë është i ndezur.	Referojuni "Funksioni i ngrirjes së shpejtë"
Në pllakëzën e pasme të ftohësit rrjedh ujë.	Gjatë procesit automatik të shkrirjes, bryma shkrin në pllakëzën e pasme.	Kjo është normale.
Brenda në frigorifer rrjedh ujë.	Vrima e daljes së ujit është bllokuar.	Pastroni vrimën e daljes së ujit.
	Produktet e pengojnë ujin të rrjedhë në kolektorin e ujit.	Sigurohuni që produktet të mos prekin pllakëzën e pasme.
Uji rrjedh në dysheme.	Uji i shkrirë që del jashtë nuk shkon në tabakanë avulluese që ndodhet mbi kompresor.	Bashkoni tubin e daljes së ujit të shkrirë me tabakanë avulluese.
Ka shumë brymë dhe akull.	Produktet nuk janë mbështjellë siç duhet.	Mbështillini ushqimet më mirë.
	Dera nuk është mbyllur mirë.	Shihni kapitullin "Mbyllja e derës".
	Rregulluesi i temperaturës mund të jetë në pozicion të gabuar.	Vendosni një temperaturë më të lartë.
Temperatura në pajisje është shumë e lartë.	Dera nuk është mbyllur mirë.	Shihni kapitullin "Mbyllja e derës".
	Temperatura e produkteve është tepër e lartë.	Lëreni temperaturën e produkteve të bjerë në temperaturën e ambientit, përpara se ta lini në ruajtje.
	Janë futur shumë produkte njëkohësisht në pajisje.	Futni më pak produkte njëkohësisht në pajisje.

Problemi	Shkaku i mundshëm	Zgjidhja
Temperatura në frigorifer është tepër e lartë.	Në pajisje nuk qarkullon ajër i ftohtë.	Sigurohuni që në pajisje të qarkullojë ajër i ftohtë.
Temperatura në ngrirës është tepër e lartë.	Produktet janë tepër afër me njëra-tjetrën.	Vendosini produktet në mënyrë të tillë që ajri i ftohtë të mund të qarkulloj.
Pajisja nuk punon.	Pajisja është e fikur.	Ndizni pajisjen.
	Spina nuk është futur mirë në prizë.	Futeni spinën mirë në prizë.
	Pajisja nuk furnizohet me korrent. Në prizën elektrike nuk kalon tension.	Lidhni një pajisje tjetër elektrike në prizë. Kontaktoni një elektricist të kualifikuar.
Llamba nuk punon.	Llamba është në gjendje gatishmërie.	Mbyllni dhe hapni derën.
"dEMo" afishohet në ekran.	Pajisja është në funksionin e demonstrimit.	Mbani shtypur për afërsisht 10 sekonda butonin Mode derisa të dëgjohet një tingull i gjatë akustik dhe ekrani të fiket për një kohë të shkurtër: pajisja fillon të punojë në mënyrë të rregullt.
Zilja tingëllon. .	Dera nuk është mbyllur mirë.	Referojuni kapitullit "Alarmi i derës së hapur".
Në vendin e afishimit të temperaturës tregohet një kuadrat lart ose poshtë.	Ka ndodhur një defekt në matjen e temperaturës.	Telefononi përfaqësuesin tuaj të shërbimit (sistemi i ftohjes do të vazhdojë t'i mbajë produktet ushqimore të ftohta, por nuk mund të bëhet rregullimi i temperaturës).

Nëse këshillat nuk sjellin rezultate, kontaktoni shërbimin më të afërt të markës së pajisjes.

7.1 Zëvendësimi i llambushkës

Pajisja ka një dritë të brendshme LED me jetëgjatësi të madhe.
Vetëm punonjësit e shërbimit lejohen që ta zëvendësojnë dritën. Kontaktoni qendrën tuaj të shërbimit .

7.2 Mbyllja e derës

1. Pastroni guarnicionin e derës.
2. Nëse është e nevojshme, rregulloni derën. Shihni paragrafin "Instalimi".
3. Nëse është e nevojshme, zëvendësoni guarnicionet defektoze të derës. Lidhuni me Qendrën e Shërbimit.

8. INSTALIMI

PARALAJMËRIM
Lexoni me kujdes kapitullin "Të dhëna për sigurinë" për sigurinë tuaj si dhe për një përdorim të saktë të pajisjes, përpara se të instaloni atë.


8.1 Pozicionimi

Instalojeni këtë pajisje në një vend ku temperatura e ambientit përputhet me klasën e klimës që tregohet në tabelën e vlerave në pajisje:

Klasa e klimës	Temperatura e ambientit
SN	+10°C deri + 32°C
N	+16°C deri + 32°C
ST	+16°C deri + 38°C
T	+16°C deri + 43°C

8.2 Vendosja

Pajisja duhet të montohet larg burimeve të nxehtësisë, të tilla si radiatorë, bojlerë, drita e drejtpërdrejtë e diellit etj. Sigurohuni që ajri të qarkullojë lirisht përreth pjesës së pasme të pajisjes. Për të siguruar performancë optimale, nëse pajisja vendoset poshtë një njësie të varur në mur, largësia minimale midis pjesës së sipërme të pajisjes dhe njësisë në mur duhet të jetë të paktën 100 mm. Sidoqoftë, në rrethana ideale, pajisja nuk duhet të vendoset poshtë njësive të varura në mur. Nivelimi i saktë sigurohet përmes një ose më shumë këmbëzave të rregullueshme në bazën e pajisjes.




PARALAJMËRIM
Pajisja duhet të shkëputet lirisht nga burimi i energjisë; si rrjedhojë, spina duhet të jetë lehtësisht e arritshme pas montimit.

8.3 Distancatorët e pasmë


Dy distancatorët mund t'i gjeni brenda çantës së dokumenteve.
Ndiqni këto hapa për të montuar distancatorët:

1. Lironi vidën.
2. Vendosni distancatorin poshtë vidës.
3. Rrotullojeni distancatorin në pozicionin e duhur.
4. Shtrëngojini vidat sërish.



8.4 Nivelimi


Gjatë vendosjes së pajisjes, sigurohuni që të qëndrojë e niveluar. Kjo mund të arrihet nëpërmjet dy këmbëzave të rregullueshme në pjesën e poshtme përballë.



8.5 Instalimi i filtrit TasteGuard

Filtri TasteGuard është filtër karboni aktiv i cili thith aromat e këqija dhe mundëson ruajtjen e shijes dhe aromës më të mirë për të gjitha ushqimet, pa rrezikuar ndotjen nga shkëmbimi i aromave.
Kur dërgohet, filtri i karbonit gjendet brenda një qeseje plastike, në mënyrë që të ruhet jetëgjatësia dhe karakteristikat e tij. Filtri duhet të vendoset pas fletëzës, përpara se të ndizet pajisja.

1. Hapni kapakun e fletëzës.
2. Hiqni filtrin nga qesja plastike.
3. Fusni filtrin në vendin që gjendet në pjesën e pasme të kapakut të fletëzës.
4. Mbylleni kapakun e fletëzës.



Filtri duhet të trajtohet me kujdes, në mënyrë që copëzat të mos shkëputen nga sipërfaqja. Filtri duhet të ndërrohet një herë në gjashtë muaj.

8.6 Lidhja elektrike

Përpara se ta futni pajisjen në prizë, sigurohuni që voltazhi dhe frekuenca që tregohet në tabelën e vlerave përputhet me të dhënat e rrymës së shtëpisë tuaj. Pajisja duhet tokëzuar. Spina e kabllitkabllos tsë ushqimit është e pajisur me një kontakt, pikërisht për këtë qëllim. Nëse spina e ushqimit të shtëpisë nuk është e tokëzuar, lidheni pajisjen në një prizë të veçuar të tokëzuar në përputhje me rregullat në fuqi, duke u këshilluar me një elektriçistelektricist.
Prodhuesi refuzon të marrë përsipër gjithë përgjegjësinë nëse nuk ndiqen masat paraprake të mësipërme.
Kjo pajisja është në përputhje me E.E.C. - Direktivat


8.7 Ndryshimi i krahut të hapjes së derës

PARALAJMËRIM
Përpara se të kryeni çdo lloj veprimi, hiqni spinën nga priza.


PARALAJMËRIM
Sigurohuni që pajisja të mos jetë në rrymë.

Ju sugjerojmë që veprimet e mëposhtme t'i kryeni së bashku me një person tjetër, i cili do t'i mbajë të palëvizshme dyert e pajisjes gjatë procesit.


- Hiqni mbulojën e menteshës me një kaçavidë (4).
- Hapni derën dhe hiqni mbulojën me kapak në fund të derës (1).
- Hiqni mbulojat e përparme të sipërme në të dyja anët. (2,6).
- Hiqni nga priza konektorin e kabllos së ekranit (3).




- Zhvidhosni menteshat dhe hiqni derën (4).




- Zhvidhosni menteshën e mesit (B). Hiqni distancatorin plastik (A)
- Hiqni distancatorin (F) dhe zhvendoseni në anën tjetër të aksit të menteshës (E).
- Çmontoni dyert.
- Hiqni kunjin e majtë mbulues të menteshës së mesit (C, D) dhe zhvendoseni në anën tjetër.
- Futeni kunjin e menteshës së mesit (E) në vrimën e majtë të derës së poshtme.




Hiqni mbulojën me ndihmën e një vegle (A) zhvidhosni aksin e poshtëm të menteshës (B) dhe vendoseni atë në anën e kundërt. Rivendosni mbulojën (A) në anë të kundërt.
Rivendoseni derën e poshtme në kunjin e menteshës (B).
Hiqni 2 mbulojat plastike dhe vendoseni atë në anën e kundërt.
Futeni kunjin e menteshës së mesit në vrimën e majtë të derës së poshtme.
Futeni derën e poshtme në kunjin e menteshës së poshtme (B).




- Nxirreni kabllon nga fundi i derës dhe vendoseni në menteshën e sipërme.
- Vidhosni sërish menteshën (7).



- Lidhni kabllon me prizën në panelin e përparmë. (8)
- Vendosni në vend mbulojat e përparme të sipërme në të dyja anët (5,9).
- Vendosni kabllon e ekranit, që aktualisht është e shkëputur, në mbajtësen e kabllos në kapakun e fundit të derës, pastaj vendosni mbulojën me kapak në fundin e derës (10)



- Hiqini kapakët (A). Hiqni tapat e kapakut (C).
- Zhvidhosni dorezat (B) dhe vendosini në anën e kundërt. Vendosni dorezën e sipërme në derën e poshtme dhe dorezën e poshtme në derën e sipërme
- Rivendosni tapat e kapakut (C) në anë të kundërt.



Bëni një kontroll përfundimtar për t'u siguruar që:

- Të gjitha vidat janë shtrënguar.
- Guarnicioni magnetik ngjitet në kasën e pajisjes.
- Dera hapet dhe mbyllet mirë.

PARALAJMËRIM
Nëse nuk dëshironi t'i kryeni vetë veprimet më sipër, kontaktoni me qendrën më të afërt të shërbimit pas shitjes. Specialisti i qendrës së shërbimit pas shitjes do të kryejë ndryshimin e drejtimit të hapjes së derës, me shpenzimet tuaja.

PARALAJMËRIM
Pas ndryshimit të drejtimit të hapjes së dyerve kontrolloni që të gjitha vidhat të jenë shtrënguar mirë dhe që guarnicioni magnetik të ngjitet në kasën e pajisjes. Nëse temperatura e ambientit është e ftohtë (p.sh. në dimër), guarnicioni mund të mos vendoset mirë në pajisje. Në këtë rast, prisni që guarnicioni të përshtatet natyrshëm. Shtrijeni pajisjen me anën e pasme poshtë.

9. TË DHËNA TEKNIKE

Dimensionet e folesë		
	Lartësia	1859 mm
	Gjerësia	595 mm
	Thellësia	658 mm
Koha e rritjes		18 orë
Tensioni		230 - 240 V
Frekuenca		50 Hz

Të dhënat teknike ndodhen në tabelën e vlerave që gjendet në anë të majtë brenda pajisjes dhe në etiketën e energjisë.

10. PROBLEME QË LIDHEN ME MJEDISIN

Ricikloni materialet me simbolin .

Vendoseni ambalazhin te kontenierët e riciklimit nëse ka.
